

VENDIM
Nr. 595, datë 18.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“SISTEMIM BLOQE BANIMI, ZOGU I, KRAHU I DJATHTË (ZYRA E PUNËS,
DREJTORIA
E BUJQËSISË)”, NË BASHKINË
E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim blloqe banimi, Zogu I, krahu i djathtë (Zyra e punës, Drejtoria e Bujqësisë)”, në Bashkinë e Shkodrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë “ndërtesë”, me sipërfaqe 10 (dhjetë) m², dhe “truall”, me sipërfaqe prej 10 (dhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 411 580 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 411 580 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Shkodër, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përba-llohet nga Bashkia Shkodër.

5. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Shkodër, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurive prej 10 (dhjetë) m² “ndërtesë” dhe 10 (dhjetë) m² “truall”, për projektin “Sistemim blloqe banimi, Zogu I, krahu i djathtë (Zyra e punës, Drejtoria e Bujqësisë)”, të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTIT “SISTEMIM BLOQE BANIMI, ZOGU I, KRAHU I DJATHTË
(ZYRA E PUNËS, DREJTORIA E BUJQËSISË)

Bashkia Shkodër

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e truallit/m²	Çmimi i truallit/lekë	Vlera në lekë	Sip. e ndërt./m²	Çmimi i ndërt./lekë	Vlera në lekë	Vlera e përgjithshme/lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Pjerin Paloka	8591	1/856	10	8511	85 110	10	32648	326 480	411 590	Konfirmim nga ZVRPP-ja
	TOTALI									411 590	